

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**  
**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**VLERËSIMI I EDUKIMIT, QËNDRIMIT DHE SJELLJES FINANCIARE NË**  
**VENDIMARRJEN FINANCIARE-RASTI I STUDENTËVE ME NDIHMË EKONOMIKE**

**Dr. Perseta Grabova<sup>1</sup>**

**Meril Canameri<sup>2</sup>**

**Merlina Guni<sup>3</sup>**

**Jona Hoxha<sup>4</sup>**

***Abstrakt***

Në shoqërinë e sotme, individët përballen me presione financiare që në një moshë shumë të re. Studimet ndërkombëtare në fushën e sjelljes dhe edukimit financiar kanë treguar që individët që përftojnë njohuri financiare që në moshë të re do të bëhen të aftë të menaxhojnë paratë e tyre, të marrin vendimet e duhura financiare duke kontribuar edhe në stabilitetin financiar të vendit të tyre. Studime të tjera argumentojnë se edukimi financiar i kufizuar përbën një pengesë të rëndësishme për të kërkuar produkte dhe shërbime financiare për familjet me të ardhura të kufizuara, pasi ato nuk i njohin ose nuk janë të familjarizuar me produkte dhe shërbime të tilla, për pasojë, nuk arrijnë t'i kërkojnë.

Nëpërmjet analizimit të perceptimeve të studentëve me ndihmë ekonomike për paranë dhe pasurinë është studiuar ndikimi që kanë faktorë të tillë si edukimi financiar, emocionet, sjellja financiare, në përdorimin e parasë apo në vendimmarrjen financiare të tyre. Për të identifikuar ndikimin e këtyre faktorëve janë përdorur të dhënat cilësore të mbledhura përmes intervistave të realizuara me studentët me ndihmë ekonomike nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Fakulteti i Gjuhëve të Huaja të Universitetit të Tiranës.

Në përgjithësi, gjetjet e këtij studimi rezultojnë të rëndësishme në lidhje me edukimin financiar të familjes. Duke kuptuar sesi faktorë të tillë si: edukimi financiar i studentëve, ndikimi prindëror në edukimin financiar, apo emocionet, mund të kontribuohet në qartësimin e mënyrës së vendimmarrjes financiare të tyre. Përderisa politikat qeveritare i japin ende përgjegjësi individëve për kursimin dhe investimin, atëherë edukimit financiar duhet t'i kushtohet gjithnjë e më shumë rëndësi që në moshë të re. Është faktuar ekzistenca e dallimeve në njohuritë financiare të grupmoshës së re të popullsisë. Gjinia, niveli apo tipi i arsimimit, karakteristikat e familjes ndikojnë në shfaqjen e këtyre dallimeve, të cilat duhen marrë në konsideratë nga politikbërësit që synojnë përmirësimin e edukimit financiar.

***Fjalët kyçe:*** *edukimi financiar, sjellja financiare, studentët, familja, ndihma ekonomike.*

---

<sup>1</sup> Pedagogë; Departamenti i Financës, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës; email: [persetagrabova@feut.edu.al](mailto:persetagrabova@feut.edu.al)

<sup>2</sup> Studente në Master Shkencor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës; email: [merilcanameri@gmail.com](mailto:merilcanameri@gmail.com)

<sup>3</sup> Studente në Master Shkencor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës; email: [merlinaguni@hotmail.com](mailto:merlinaguni@hotmail.com)

<sup>4</sup> Studente në Master Shkencor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës; email: [jona.hoxha9@gmail.com](mailto:jona.hoxha9@gmail.com)